



**VENDIM**

**Nr. 149 Datë 07.12.2011**

**PËR**

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT UNIK TË SHITJES SË ENERGJISË  
ELEKTRIKE PËR TË LIÇENSUARIT PËR PRODHIMIN E  
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET E RINJ ME  
FUQI TË INSTALUAR DERI NË 15 MW PËR VITIN 2012**

Në mbështetje të neneve 9, 26 pika 1, 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 87, date 16.01.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 27 date 19.01.2007”, “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, neneve 15, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Vendimit nr. 24, datë 11.04.2007, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të liçensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 10 MW”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.12.2011, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve për përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për të liçensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW, për periudhën e tretë rregullatore,

## **Vendosi :**

1. Çmimi unik i shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW për vitin 2012, do të jetë 9.3 lekë/kWh.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e të licencuarve dhe KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 01.01.2012.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol RAMADANI**